

VENDIM
Nr.31, datë 19.7.1997

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese,
Hilmi Dakli,	Anëtar i “““
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Halil Kopani,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““
Veli Budo,	Anëtar i “““

me sekretare Drita Filto, më datën 11.7.1997, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.38 Akti që i përket:

KËRKUES:

1. PARTIA LËVIZJA E LEGALITETIT, në mungesë.
2. PAULIN SKANDAJ, kandidat për deputet i Partisë Lëvizja e Legalitetit.
3. PARTIA DEMOKRISTIANE, e përfaqësuar nga Z.Gasper Madhi e Av.Shqipe Koçiu.

SUBJEKT I INTERESUAR: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, i përfaqësuar nga sekretari, Z. Thimjo Kondi.

OBJEKTI:

Shfuqizimin e vendimit nr.1281, datë 7.7.1997 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që i përket zonës nr.19.

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi dëgjoji kandidatin për deputet, përfaqësuesen e Partisë Demokratiane, subjektin e interesuar, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin e tij nr.1281, datë 4.7.1997 të komunikuar më datë 7.7.1997, duke konstatuar se komisioni i zonës nr.19 Lezhë nuk ka hartuar procesverbalin e përfundimit të votimit ka nxjerrë vetë rezultatin e votimit mbi bazën e procesverbaleve të 35 qendrave të votimit, duke arritur në përfundimin se në atë zonë duhet të zhvillohet balotazhi midis kandidatit Ndrec Mark Pema i Partisë Socialiste dhe Kol Nik Biba i Partisë Demokratiane.

Partia Lëvizja e Legalitetit duke e kundërshtuar vendimin e sipërm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka pretenduar se balotazhi duhet të zhvillohej midis kandidatit të Partisë Socialiste dhe kandidatit të Partisë Lëvizja e Legalitetit, pasi ky i fundit ka fituar më shumë vota nga ai i Partisë Demokratiane.

Nga verifikimi i procesverbaleve të qendrave të votimit dhe dokumentave të tjera, të hartuara ditën e zgjedhjeve, më 29.7.1997, rezulton se pretendimet e anës kërkuese janë të pabazuara. Rezultatet e nxjerra në bazë të të dhënave të procesverbaleve nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë të sakta.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 26 e vijues të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", njëzëri,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesave.

Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.

Tiranë, më 19.7.1997